



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 11 qershor 2018
Nr. ref.: RK 1275/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI55/18

Parashtrues

Jovan Jovanović

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë
Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-158/2015, të 8 nëntorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Jovan Jovanović nga Prizreni (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Žarko Gajić, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i AKP-së) [GSK-KPA-A-158/2015], të 8 nëntorit 2017.
3. Aktgjykimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 11 dhjetor 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të AKP-së, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 i Protokollit 1 (Mbrotjtja e pronës) të Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesi kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme, me të cilën do të pezullohet Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të AKP-së [GSK-KPA-A-158/2015] i 8 nëntorit 2017.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 27 [Masat e përkohshme], nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 54 [Kërkesa për masa të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 11 prill 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 18 prill 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përberë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
9. Më 10 maj 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës i dorëzoi Kolegjit të Apelit të AKP-së.
10. Më 28 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 qershor 1996, parashtruesi i kërkesës nënshkroi një para-kontratë [Nr. 154/2-96], me të cilin hyri në marrëdhënie afariste me Ndërmarrjen Shoqërore “Stan” (në tekstin e mëtejme: NSH “Stan”) nga Prizreni, me qëllim të investimit të përbashkët në ndërtimin e një lokali afarist në hapësire prej 20.57 m² në Prizren, rruga “Çylhani” 2/12.
12. Të njëjtën datë, parashtruesi i kërkesës dhe personi i autorizuar i NSH “Stan” nënshkruan një kontratë të përbashkët investimi [Nr. 154/3-96], me të cilin parashtruesi obligohet të paguajë një pjesë të vlerës së kontratës në shumën prej 50% (shuma prej 72,632.70 dinarë) në llogarinë e NSH “Stan”, jo më vonë se më 24 qershor 1996, ndërsa pjesën e mbetur të mjeteve financiare, sipas kontratës, parashtruesi duhej të paguante direkt para pranim-dorëzimit të lokalit.
13. Më 25 qershor 1996, parashtruesi i kërkesës ka paguar 47.5% të çmimit të kontratës, përkatësisht 69.006,00 dinarë, në arkë të NSH “Stan”.
14. Më 20 tetor 2006, parashtruesi paraqiti kërkesë [KPA 16300] në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtave pronësore dhe kthimin e lokalit afarist të lartpërmendur.
15. Më 14 maj 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti urgjencë në AKP, duke kërkuar përsheptimin e procedurës dhe marrjen e vendimit sipas kërkesës së tij nr. KPA 16300.
16. Më 14 maj 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë të re në AKP, me të cilën kërkoi informata për statusin e lëndës nr. KPA 16300.
17. Më 12 prill 2013, parashtruesi përsëri paraqiti kërkesën në KPA me kërkesë *“ta zgjidhni kërkesën time që unë e kam dorëzuar që në vitin 2006, për të cilin ende nuk kam marrë përgjigje”*.
18. Më 28 maj 2013, parashtruesi paraqiti kërkesë për shikim në rastin dhe marrjen e informatave për statusin e lëndës nr. KPA 16300.
19. Më 21 tetor 2014, AKP-ja nxori Vendim grupor [KPPCC/D/C/264/2014], me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesit me arsyetimin *“se ankuesi ka dëshmuar se ka paguar vetëm 47.5 % të çmimit të rënë dakord, edhe pse një kontratë për bashkimin e mjeteve dhe të punës, si dhe një fletëpagesë për pagesën e pjesës së shumës së paguar, janë gjetur dhe pozitivisht janë verifikuar, ankuesi nuk ka arritur të paraqet dëshmi të reja dhe për këtë arsye nuk ka dëshmuar se ka fituar të drejtën e pronësisë...”*.
20. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) kundër vendimit të AKP-së të 21 tetorit 2014.
21. Më 9 janar 2015, KKPK-ja nxori vendim me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesit, në pajtim me nenin 8.8 të Aneksit III të Urdhëresës

Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për AKP-në.

22. Më 5 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të AKP-së kundër Vendimit të KKPK-së [KPCC/D/C/264/2014], të 21 tetorit 2014.
23. Më 8 nëntor 2017, Kolegji i Apelit i AKP-së nxori Aktgjykimin [GSK-KPA-A-158/2015], me të cilin ankesa e parashtruesit të kërkesës u refuzua si e pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit, *inter alia*, thuhet: “Gjykata Supreme konsideron se KKPK ka marrë vendim të drejtë për refuzimin e padisë, duke theksuar se ankuesi nuk ka vërtetuar të drejtën pronësore para ose gjatë konfliktit, pavarësisht faktit se ai ka paguar 47.5 % të çmimit total të blerjes. Prova e vetme në të cilën ankuesi përcaktohet si pronar i supozuar është një kontratë, e cila nuk është e konfirmuar nga gjykata, e cila, si e tillë, nuk e përbën të drejtën pronësore të supozuar – që nënkupton se kërkohet një formë e shkruar, e vërtetuar nga autoritetet dhe e regjistruar si pronë në regjistrat publik (Neni 20 i Ligjit mbi bazën e marrëdhënieve pronësore juridike)”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është fakt i pakontestueshëm se nuk e ka përmbushur obligimin e tij në tërësi që e kishte ndaj NSH “Stan”, por megjithatë ai ka fituar të drejtë të caktuar mbi pronën e kontestuar, dhe atë në një pjesë ideale, duke paguar shumën prej 47.50% të çmimit të kontraktuar në lokalin afarist lëndor, dhe në bazë të kontratës u bë bashkëpronar.
26. Parashtruesi i kërkesës konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij sipas nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse “Kolegji i Apelit i AKP-së nuk e ka përfill faktin se Marrëveshja për investime të përbashkëta me nr. 154/3-96 e 19.06.1996 është lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personit të autorizuar të NSH “Stan”, dhe kjo paraqet një kontratë të vlefshme me të cilën parashtruesi i kërkesës ka fituar të drejtën për një pjesë ideale prej 47.25% të dyqanit në fjalë, dmth përmes arritjes së Marrëveshjes ai u bë bashkëpronar i objektit të kontestuar.”
27. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1, sepse “Kolegji i Apelit i AKP-së nuk ka marrë parasysh ose nuk ka hyrë në përmbajtjen e Kontratës mbi investimin e përbashkët, i cili në të gjitha aspektet ka karakterin e para-kontratës, me të cilin pas përmbushjes së obligimeve do të ishte bërë një kontratë e re e cila do të ishte konfirmuar në gjykatë dhe ligjërisht do të ishte e plotfuqishme”.

28. Parashtruesi kërkon nga Gjykata ta deklarojë kërkesën të pranueshme, ta aprovojë masën e përkohshme, me të cilën do të pezullohet Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të AKP-së [GSK-KPA-A-158/2015], dhe ta kthej rastin në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të arsyetuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregulloren e punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.

32. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe ka parashtruar kërkesë brenda afatit të caktuar.

33. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

34. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i konteston vendimet dhe aktgjykimet e gjykatave të rregullta, duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat nga nenet 24, 31, 32 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe nga neni 6 dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së, sepse gjatë procedurës gjyqësore ai nuk ka mundur të ushtrojë të drejtat e tij pronësore mbi lokalin afarist mbi të cilin konsideron të ketë të drejtë, bazuar në kontratën për ndërtim të përbashkët që e kishte lidhur me NSH “Stan” në 2006.
36. Gjykata vëren se procedura e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në gjykatat e rregullta kishte të bënte me vërtetimin e të drejtave pronësore, që përbën të drejtë private dhe si e tillë, të drejtë civile, në të cilën zbatohen standardet e gjyimit të drejtë sipas nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së.
37. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimin e shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së e lidh me faktin se gjykatat nuk morën parasysh se kontrata për investim të përbashkët [Nr. 154/3-96], e 19 qershorit 1996, u lidh në pajtim me ligjin e atëhershëm në fuqi, ndërmjet parashtruesit dhe personit të autorizuar të NSH “Stan” dhe, në përputhje me këtë, ai përbën kontratë të plotfuqishme me të cilën fitoi të drejtën në pjesën ideale prej 47.5% të pronësisë mbi lokalin afarist, dhe rrjedhimisht, gjykatat e rregullta është dashur të zbatojnë ligjin që ishte në fuqi në atë kohë.
38. Në këtë drejtim, Gjykata së pari thekson se, sipas praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), detyrë e Gjykatës nuk është të shqyrtojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Ruisë*, Vendimi për pranueshmërinë, të 30 qershorit 2005, Kërkesa nr. 65167/01).
39. Gjykata gjithashtu përsërit se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkalës së katërt”, (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Akdivar kunder Turqisë*, nr. 21893/93, të 16 shtatorit 1996, para. 65, shih, gjithashtu, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese: rasti KI86/11, parashtruesi: *Milaim Berisha*, të 5 prillit 2012).
40. Duke i pasur parasysh pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se AKP-ja në Vendimin KPPCC/D/C/264/2014 gjeti si fakt të pakontestueshëm që parashtruesi i kërkesës dhe NSH “Stan” kishin nënshkruar kontratë për ndërtimin e përbashkët të lokalit afarist, e që ishte objekt i kontestit, dhe se kontrata përmbante kushtet e përshkruara, si dhe mënyrën e pagesës së çmimit të kontraktuar për lokalin afarist.
41. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se AKP-ja gjeti se kjo kontratë ishte e nënshkruar ekskluzivisht ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personit

kompetent si përfaqësues i NSH “Stan”, në formë që nuk është përcaktuar me ligj.

42. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në bazë të shkresave të lëndës dhe vendimit të AKP-së, gjykatat e rregullta gjetën se kontrata për ndërtimin e përbashkët të lokalit afarist nuk është lidhur në formën e përshkruar në gjykatë, për çka ai nuk ka mund të merr formë të plotfuqishme ligjore, siç rregullohet me ligj, dhe një veprim i tillë nuk mund të konsiderohet në vetvete si veprim juridik i vlefshëm me të cilin ai do të mund të fitojë të drejtë pronësore ose bashkëpronësore mbi pronën lëndore përkatësisht lokalin afarist.
43. Gjykata gjithashtu vëren, se edhe Kolegji i Apelit i AKP-së mori parasysh të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me pronën nw fjale , me ç'rast edhe konkludoi se *“Prova e vetme në të cilën ankuesi përcaktohet si pronar i supozuar është një kontratë, e cila nuk është e konfirmuar nga gjykata, e cila, si e tillë, nuk e përbën të drejtën pronësore të supozuar”*.
44. Rrjedhimisht, Gjykata nuk e sheh arbitraritetin nga arsyetimi i dhënë, për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i AKP-së i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të theksuara gjatë procedurës së rregullt dhe ka ofruar konkluzione të qarta për arsyet pse këto pretendime janë të pabazuara.
45. Bazuar në këtë, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkëljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së janë të pabazuara.
46. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së është shkelur neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, sepse *“Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh ose nuk ka hyrë në përmbajtjen e Kontratës mbi investimin e përbashkët, i cili në të gjitha aspektet ka karakterin e para-kontratës, me të cilin pas përmbushjes së obligimeve do të ishte bërë një kontratë e re e cila do të ishte konfirmuar në gjykatë dhe ligjërisht do të ishte e plotfuqishme”*.
47. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykatat në vendimet e tyre, si dhe Kolegji i Apelit i AKP-së në aktgjykim kanë konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur ta fitojë të drejtën mbi pronën në fjalë pasi që nuk ka përmbushur asnjë nga kushtet e specifikuara për t'i mundësuar atij që të pretendojë se kishte fituar të drejtën pronësore ose bashkëpronësore mbi lokalin afarist.
48. Për më tepër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka theksuar në kërkesën e tij se ishte në dijeni të faktit se kishte lidhur vetëm kontratën paraprake dhe se në ndonjë periudhë të ardhshme, pas përmbushjes së detyrimeve kontraktuale *“[...] do të bëjë një kontratë të re e cila do të ishte vërtetuar në gjykatë dhe ligjërisht do të ishte e plotfuqishme”*.
49. Në këtë drejtim, Gjykata pretendon se një e drejtë mund të konsiderohet si e drejtë në pronë vetëm atëherë kur për këtë ekziston baza ligjore, përkatësisht, nëse pajtueshmëria është fituar në bazë të rregullave ligjore përmes trashëgimisë apo transaksionit ligjor.

50. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka fituar pronën në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, pasi e drejta në pronë nuk ekziston deri në momentin kur personi nuk ka të drejtë mbi pronë të caktuar në fjalë. Me fjalë të tjera, e drejta në pronë nuk nënkupton edhe të drejtën e fitimit të pronës (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ, *Marckx kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, Kërkesa nr. 6833/74).
51. Në bazë të të gjithë kësaj të cekur më lart, Gjykata e sheh këtë kërkesë të parashtruesit si shprehje e pakënaqësisë me faktin se kërkesa e tij me të cilën kërkoi ushtrimin e të drejtave të tij pronësore u refuzua si e pabazuar në të gjitha instancat, gjë që në rastin konkret nuk është drejtpërdrejtë as tërthorazi rezultat i mungesës së gjykimit të drejtë.
52. Për më tepër, sa i përket pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës se me vendimet e kontestuara i janë shkelur edhe e drejta e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit], dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, Gjykata vëren se parashtruesi nuk arsyetoi në mënyrë të veçantë çfarë përbën shkeljen e pretenduar të këtyre të drejtave. Gjegjësisht, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve të tij, nuk ka ofruar ndonjë argument apo prova për të mbështetur këto pretendime, përkatësisht, që do të tregonin se shkelja e këtyre të drejtave të pretenduara ishte e mundur në procedurën lëndore. Në bazë të kësaj, rrjedh se nuk ka as elemente që *prima facie* dëshmojnë se shqyrtimi i tyre meritohet do të ishte i nevojshëm.
53. Gjykata konsideron se është obligimi i parashtruesit për të mbështetur pretendimet e tij kushtetuese dhe për të paraqitur dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutën dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në pajtim me kompetencën e Gjykatës (shih: Rasti nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Gjykata Kushtetuese, të 5 dhjetorit 2013).
54. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon në shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
55. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesë për masë të përkohshme

56. Gjykata rikujton që parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme me të cilën Aktgjykimi [GSK-KPA-A-158/2015] i Kolegjit të Apelit të AKP-së do të shfuqizohet. Megjithatë, parashtruesi në arsyetimin e kërkesës së tij me asnjë fjali të vetme nuk shpjegoi pse një veprim i tillë i Gjykatës do të ishte i nevojshëm.
57. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, i cili përcakton:

1. "Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".

58. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës; (...)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

59. Gjykata rithekson konkluzionin që kërkesa e parashtruesit është shpallur e papranueshme, si qartazi e pabazuar, pasi që parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës.

60. Prandaj, në pajtim me nenin 116.2 të Kushtetutës, nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c), (d) dhe (2), (b), 55 (4) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 maj 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi